



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1061/2 Prot.

Tiranë, më 07 . 08 . 2025

V E N D I M

Nr. 183 , Datë 07 . 08 . 2025

Bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 153, datë 07.07.2025¹, e paraqitur nga znj. F.M kundër z. E.D, Kryetar i Bashkisë Vlorë², z. S.T, Shef i Kabinetit të Kryetarit³ dhe znj. L.B, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore⁴, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes familjare⁵” dhe “çdo shkak tjetër⁶”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me email-in datë 18.07.2025, subjekti ankues, në mes të tjerash ka parashtruar se: *“Po parashtroj një ankesë për diskriminim të vazhdueshëm në vendin e punës, si në aspektin administrativ, ashtu edhe në trajtimin njerëzor dhe institucional që më është rezervuar ndër vite nga drejtues të institucioneve ku kam ushtruar*

¹ Me email-in datë 14.07.2025, Inspektor i çështjes ka kërkuar nga ankuesja, informacion dhe dokumentacion plotësues.

² Për përgjegjësi vendimmarrëse në krijimin dhe mbështetjen e një klime përjashtuese, selektive dhe në kundërshtim me parimet e barazisë.

³ Për sjellje sistematike diskriminuuese, përfshirë etiketime si “spiune”, kërcënime verbale publike (“do të të zhduk nga bashkia”), dhe përhapje ndikimi për përjashtimin tim nga funksionet e institucionit.

⁴ Për selektivitet në shpalljen e vendeve të punës, mungesë transparence në strukturë dhe përjashtim të qëllimshëm nga komunikimet dhe zhvillimet profesionale.

⁵ Jam nënë e dy vajzave të mitura. Në disa raste, kur kam qenë me leje për arsye familjare, janë ndërmarrë veprime që kanë ndikuar drejtpërdrejt në pozitën time në institucion, siç është marrja e shkresave zyrtare nga zyra ime në mungesën time dhe zhvillimi i mbledhjeve apo vendimmarrjeve që më përjashtonin.

⁶ Që prej vitit 2022, jam përballur me etiketime të përsëritura dhe të pavërteta, me qëllim njollosjen e reputacionit tim profesional, përfshirë përhapjen e etiketës si “spiune e SHIK-ut”, e cila bëhej për faktin se bashkëshorti im ka shërbyer deri në vitin 2023, pranë Shërbimit Informativ të Shtetit.

detyrën si juriste pranë Bashkisë Vlorë. Konkretisht, në vijim paraqes një përmbledhje të trajtimit diskriminues:

- Jam përjashtuar nga njoftimet, mbledhjet dhe funksionet kolegjiale të zyrës.
- Struktura e Drejtorisë ku unë punoja nuk është zbardhur dhe për pozicionin tim, nuk është shpallur asnjëherë vendi i punës.
- Drejtoresha e Burimeve Njerëzore ka shpallur vende të tjera për persona të tjerë, pa shpallje gare dhe me trajtim preferencial. Punësime të disa juristeve në Drejtorinë Juridike.
- Vendimmarrjet janë marrë në mënyrë të njëanshme dhe në mungesë të plotë të komunikimit me mua.
- Në Drejtorinë ku ushtroj funksionin si juriste, nuk është shpallur vendi i punës për qëllime aplikimi për status nëpunësi civil. Ndërkohë, në drejtori të tjera janë emëruar juriste pa përvojë, të cilave u është njohur statusi i nëpunësit civil në mënyrë selektive dhe të njëanshme, pa ndjekur procedura konkurrimi.
- Nuk jam përfshirë në asnjë trajnim profesional, ndonëse trajnimet kanë qenë të njohura për drejtuesit. Kolege të reja, të komanduara ose të sapopunësuar, kanë marrë pjesë rregullisht. Asnjë njoftim nuk më është dërguar për të aplikuar apo për të marrë pjesë në ndonjë trajnim.
- Për një kohë të gjatë, jam përjashtuar nga ndarja e detyrave që lidhen me funksionin tim bazë. Detyrat janë deleguar pa shkresë zyrtare dhe pa komunikim formal, tek persona të tjerë, duke më lënë në pozicion pasiv dhe pa përfshirje në vendimmarrje.
- Nuk kam marrë asnjë vërejtje apo masë disiplinore.
- Nuk ekziston asnjë urdhër pune ku jam e përfshirë në mënyrë aktive, gjatë gjithë periudhës së punës sime në Drejtorinë e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve (DPPMA).

Me Vendimin nr. 50, datë 17.06.2025, jam transferuar në një njësi jashtë qytetit të Vlorës (Njësia Administrative Qendër), pa asnjë konsultim, njoftim paraprak apo vlerësim të gjendjes sime personale dhe familjare. Jam nënë e dy fëmijëve të mitur, me bashkëshortin në detyrë si oficer shteti, si dhe me përgjegjësi financiare (dy kredi aktive). Transferimi është në një zonë pa transport publik dhe me ulje page, çka përbën një dëm të shumëfishtë dhe të papërballueshëm.

Të gjithë këto elementë përbëjnë një trajtim të pabarabartë dhe diskriminim në vendin e punës, si për nga përjashtimi sistematik nga të drejtat dhe mundësitë, ashtu edhe për nga masa e fundit e transferimit që e bën të pamundur, vijimin normal të jetës dhe detyrës.

Kam konstatuar shkelje nga z. D.D që prodhonte dy shkresa me të njëjtin objekt me data të ndryshme dhe numër protokoll ndryshe (vendimi nr. 57, datë 31.05.2024 dhe vendimi nr. 69, datë 20.06.2024), humbjen e korrespondencës për shkresat e qytetarëve dhe marrjen e kontratës për shfrytëzimin e hapësirës publike, duke nxjerrë jashtë institucionit për të firmosur një shtetas të huaj. Duke i evidentuar këto fakte dhe duke i kundërshtuar herë pas here, filloi në muajin prill një lloj diskriminimi: me listëprezencën që del në orën 8 dhe hiqet në 16, sapo unë hyja, hiqej nga këshilltarja J.D; kur shkoja në supermarket ose protokoll, shkonte për të marrë

prezencën dhe vendoste mungesë - për këtë kam sinjalizuar shefin e kabinetit (disponoj korrespondencë me cular).

Gjithashtu, kam sinjalizuar Drejtorin e DPPMA, z. J.J, për kompjuterin tim, i cili rezultonte se ishte i lidhur me një kompjuter tjetër dhe sa herë më kërkohej një punë urgjent, porosi e Kryetarit, mua më bllokohej kompjuteri, dhe më është përgjigjur s'ka problem sikur çfarë ke ti në kompjuter nga muaji gusht të vitit 2024, deri në dhjetor, më kërkonin duke ushtruar presione të ndryshme për të lidhur kontrata për parkime, lavazho dhe tabakino.

Në muajin dhjetor nëpërmjet punonjësit A.H, më kanë vjedhur shkresat nga sirtarët e mi, pasi rastet i trajtonin sipas bindjeve dhe interesave personale, në kundërshtim me ligjin, kam kthyer të gjitha dosjet dhe në muajin dhjetor, ky drejtor ka lidhur kontrata një ditore për parkime, lavazho, të gjitha në kundërshtim me ligjin. Në datë 12.02.2025, më kanë treguar një vendim i cili është kompetencë e komisionit për shfrytëzimin e hapësirës publike, z. D.D, Drejtor Juridik, ish Drejtoresha e Taksave Vendore, znj. A.Sh dhe ish Drejtori i Urbanistikës, z. K.M. Ky vendim kishte nënshkrimin tim. Me marrjen dijeni, kam kërkuar takim me Kryetarin dhe vajzave të paradhomës u kam lënë dosjen me materiale, shkëmbim korrespondence dhe një relacion, ku parashtroja faktet dhe kërkesën për shfuqizimin e këtij vendimi. Kryetari më ka pritur në datë 20 shkurt, duke mos e pranuar fillimisht, ekzistencën e këtij vendimi dhe duke më përdorur shprehjen, gjueti shtrigash, më kërkoi mos protokollimin e relacionit, se do e shqyrtonte dhe do merrte masat. Dhe masa ishte dërgimi im në një zonë jashtë Vlorës, ku nuk ka as transport publik, për të më diskriminuar. Gjithashtu, drejtori zhvillonte mbledhje duke mos më përfshirë dhe detyrat e mia i ushtronte, juristja e Drejtorisë Juridike, refuzonte të më jepte leje dhe nuk donte kontakt fare me mua. Në datë 30.06.2025, kam dërguar kolegun e zyrës z. Th.Q, për të firmosur lejen time dhe sërish ka refuzuar me shprehjen “nuk është më punonjësja ime”. Për këtë kam dorëzuar lejen në protokoll me shkresë përcjellëse. Gjithashtu, kam vënë re se për shkak të një paragjykimi lidhur me faktin që bashkëshorti im ka punuar pranë Shërbimit Informativ të Shtetit, jam përjashtuar sistematikisht nga dëgjimi dhe pjesëmarrja në procese vendimmarrëse, duke më privuar nga të drejtat e mia, në mënyrë të padrejtë dhe diskriminuese”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në pozicionin fillestar të punës.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me identifikimin e subjekteve kundër të cilëve drejtohej ankesa, shkaqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 14.07.2025, Inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues, si më poshtë:
 1. Duhet të identifikoni subjektin kundër të cilit ankoheni (në formularin e ankesës keni vendosur 6 subjekte: Kryetari i Bashkisë Vlorë, Shefi i Kabinetit, Drejtorit Juridik,

Këshilltares, Drejtores së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit të DPPMA-së, për të cilët duhet të shpengoni situatën/at e pretenduara për diskriminim).

- 2. Shpjegime, fakte dhe prova për të identifikuar shkakun “gjendja familjare” dhe një kopje të certifikatës familjare.*
- 3. Shpjegime, fakte dhe prova për të identifikuar shkakun “çdo shkak tjetër”.*
- 4. Duhet të saktësoni kush janë veprimet konkrete të paligjshme/pafavorshme/pabarabarta të drejtuesve të Bashkisë Vlorë, të shoqëruara me fakte dhe prova të periudhës që pretendoni për diskriminim dhe si lidhen ato me “gjendjen familjare”, apo me “çdo shkak tjetër”.*
- 5. Fakte dhe prova, nëse jeni ankuar lidhur me mosnjohjen e statusit të nëpunësit civil, kush janë punonjësit me të cilët krahasoheni, për këtë pretendim dhe si lidhet me shkaqet e pretenduara.*
- 6. Fakte dhe prova, nëse jeni ankuar lidhur me mos përfshirjen në trajnime, kush janë punonjësit me të cilët krahasoheni, për këtë pretendim dhe si lidhet me shkaqet e pretenduara.*
- 7. Fakte dhe prova, nëse jeni ankuar lidhur me mos delegimin e detyrave, kush janë punonjësit me të cilët krahasoheni, për këtë pretendim dhe si lidhet me shkaqet e pretenduara.*
- 8. Fakte dhe prova, nëse jeni ankuar lidhur me lëvizjen në detyrë (transferimin).*

Në përgjigje të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, subjekti ankues, me email-in datë 18.07.2025, dërgoi informacion dhe një kopje të certifikatës familjare.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi.

Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”⁷.*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të të KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar

⁷ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një

trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i saj, i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, Shefi i Kabinetit të Kryetarit dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ka ardhur për shkak të gjendjes familjare dhe për çdo shkak tjetër.

Së pari, dokumentimi i shkakut për të cilin pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesi pretendon se ka ardhur si pasojë e posedimit të tij.

Së dyti, pasi ankuesi të ketë provuar se mbart shkakun e pretenduar, duhet që të sjellë indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këtë shkak/qe, (gjendja familjare dhe çdo shkak tjetër), ajo është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga subjektet kundër të cilëve drejtohet ankesa.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe kriteret e përcaktuara, Komisioneri vlerëson se, nuk rezulton që nga ana e ankueses të jetë provuar diferenca në trajtim nga ana e subjekteve, *për shkak të gjendjes së saj familjare*⁸, si nënë e dy fëmijëve të mitur, 11 dhe 7 vjeç dhe për çdo shkak tjetër.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes familjare, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon një shkak të mbrojtur, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkakun e pretenduar, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi është gjendja familjare e ankueses.

Pala ankuese nuk parashtroi fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të subjekteve kundër të cilëve drejtohet ankesa, që të jenë motivuar apo nxitur nga gjendja e saj familjare, pasi dhe përpara vitit 2024, periudhë kur ankuesja pretendon për veprime diskriminues, ajo ka qenë nënë e dy fëmijëve të mitur. Për këtë arsye, Komisioneri vlerëson se pretendimet e paraqitura nga ankuesja, nuk mund të përfshihen në kuadër të gjendjes

⁸ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/> “Gjendja familjare ose martesore ka të bëjë me marrëdhëniet martesore, farefisnore ose prindërore të cilat një person ka me persona tjerë. Gjendja familjare ose martesore mund të ndryshojë ndërmjet individëve, pasi ata mund të jenë të martuar ose jo, në një marrëdhënie de facto ose në një marrëdhënie që nuk e njeh ligji, të divorcuar ose të ve, jetojnë në një familje të zgjeruar ose kanë përgjegjësi të ndryshme për fëmijët dhe personat e varur ose një numër të caktuar fëmijësh. Në këtë kuptim, konsiderohet edhe shkak i lidhur me gjendjen civile”.

familjare. Për rrjedhojë Komisioneri, vlerëson se, nuk provohet ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, “gjendja familjare”.

Subjekti ankues ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, Shefit të Kabinetit të Kryetarit dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe për çdo shkak tjetër, duke pretenduar se është gjendur në një situatë diskriminuese, situatë e cila supozohet se ka si shkak se bashkëshorti i saj ka shërbyer deri në vitin 2023, pranë Shërbimit Informativ të Shtetit dhe se ajo etiketohej si “spiune e SHIK-ut”.

Lidhur me këtë, ankuesja nuk ka depozituar asnjë dokument që të vërtetojë këtë pretendim, si dhe nuk parashtron fakte, nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të personave kundër të cilëve drejtohet ankesa, që të jetë motivuar apo nxitur nga profesioni i bashkëshortit të saj, për më tepër që për periudhën kur ankuesja pretendon veprime diskriminuese (nga viti 2024 e në vijim), bashkëshorti i saj nuk ka qenë më pjesë e SHIK-ut.

Dokumentimi i një karakteristike individuale është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas, të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosdokumentimit dhe mospërcaktimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me një karakteristikë individuale.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë shkaqesh⁹. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

⁹ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrotjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrotjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh¹⁰.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrotjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrotur”, të cilën ankuesja nuk arriti ti provonte e dokumentonte se i posedonte ato.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri apo trajtim të pabarabartë, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson, se ankuesja nuk ka dhënë informacion për të shpjeguar dhe dokumentuar gjendjen e saj familjare dhe çdo shkak tjetër, në kuptim të ligjit “*Për Mbrotjen nga Diskriminimi*”.

¹⁰ Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj¹¹.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 153, datë 07.07.2025, të znj. F.M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

¹¹ Për analogji citojmë vendimet: nr. 260, datë 03.10.2024, nr. 277, datë 14.11.2024 dhe nr. 88, datë 14.04.2025, të KMD-së.